

**Nr. Prot. 028/B/17**

## VENDIM Nr. 978

Për

### **Miratimin e Planit të Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Brezitet Frekuencor 1900 - 1920 MHz, 1920-1980/2110-2170 MHz dhe 2010 -2025 MHz për Shërbimet Mobile të Radio Komunikimeve UMTS/IMT -2000 dhe IMT e Avancuar**

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 1) dhe 2), nenit 9 paragrafi 3.6), nenit 10 paragrafi 11) dhe 12), nenit 45 paragrafi 1) dhe 2) dhe nenit 79 paragrafi 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji ose LKE*) dhe të nenit 20 të Rregullores së Brendshme (*Ref. Nr.Prot.161/06*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik GASHI, Kryetar,
- 2) z. Nijazi ADEMAJ, Anëtar,
- 3) z. Hazir HAJDARI, Anëtar,
- 4) z. Bahri ANADOLLI, Anëtar,
- 5) z. Shqiprim PULA, Anëtar

në mbledhjen e 16 të mbajtur më datë 19 Prill 2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DMF, unanimisht morri këtë:

## V E N D I M

- I. Miratohet Plani i Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Brezitet Frekuencor 1900 - 1920 MHz, 1920 - 1980/2110 - 2170 MHz dhe 2010 - 2025 MHz për Shërbimet Mobile të Radio Komunikimeve Elektronike UMTS/IMT - 2000 dhe IMT e Avancuar.
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Me Vendimin nr. 894 (*nr. prot. 043/B/16*) është miratuar fillimi i konsultimit publik për Planin e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezitet frekuencor 1900 - 1920 MHz, 1920 - 1980/2100 - 2170 MHz dhe 2010 - 2025 MHz për shërbimet mobile të radio komunikimeve UMTS/IMT - 2000

Faqe 1 nga 2

dhe IMT e avancuar, i cili ka zgjatuar një muaj. Mirëpo, asnjëri nga operatorët nuk ka paraqitur komente.

Ligji, respektivisht neni 10 (Kompetencat e Autoritetit) paragrafi 11) përkufizon se Autoriteti miraton Planin Kombëtar të numeracionit, Planin për përdorimin e Radio-Frekuencave (kanaleve) dhe planet e zhvillimit të radio komunikimit dhe paragrafi 12) përkufizon se Autoritetit menaxhon resurset e fundme – spektrin e radio-frekuencave dhe hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike.

Neni 45 paragrafi 1 i Ligjit përcakton se: *“Autoriteti, në përputhje me procedurat dhe kushtet e paraqitura në këtë ligj do të menaxhojë me resurset e komunikimeve elektronike. Spektri frekuencor (kanalet), numrat telefonik, emrat, adresat, kodi shtetëror i Internetit dhe resurset tjera të komunikimeve elektronike duhet të menaxhohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji”* dhe paragrafi 2 përcakton se: *“Spektri frekuencor (kanalet) do të menaxhohet duke u bazuar në Planin Kombëtar të Radio-frekuencave dhe Planin për përdorimin e radio-frekuencave (kanaleve) konform planeve zhvillimore për radio komunikime.”*

Duke pas parasysh atë që u tha më lart Bordi vendosi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 25/04/2017**

#### **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi  
Kryetar i Bordit**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave, ARKEP
- Arkivës së ARKEP